

Draft per vleresimin e ndikimit ne mjedis per aktivitetin

‘Shkrirje e aluminit, trajtimi i orofileve te aluminit, ngjyrosja e tyre si dhe instalimi i paneleve fotovoltaike per nevoja te vet proceseve teknologjike’



Subjekti: “ALUMIL-ALBANIA”sh.p.k. Tirane

Vendndodhja: Autostada Tirane-Durres, km 7, Katundi i Ri, Kasha, Tirane.

Projektoi: “EKO-STUDIO-PROJEKT”shpk, Tirane

Tirane Tetor 2015

PERMBAJTJA

- + Hyrje
- + Baza ligjore
- + Metodika e vleresimit te mjedisit
- + Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT
 2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI
 3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS
 4. MASAT PER ELEMINIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE
 5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME
-

1. Hyrje

Aktiviteti njerzor qe zhvillohet ne cdo aspekt te vetin, pervec dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e ardhshem te shoqerise.

Revolucioni industrial i filluar rreth dy shekuj me pare, ka disa dhjete vjecare qe ka vene njerzimin para sfidash te medha. Zhvillimet teknologjike dhe nevojat per to kane detyruar dhe ndergjegjen shoqerore per qendrimet me aktive.

Pavarsisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit.

Shkrirje e aluminit, trajtimi i profileve te aluminit, ngjyrosja e tyre si dhe instalimi i paneleve fotovoltaike per nevoja te vet proceseve teknologjike’.

Mbrojtja e mjedisit, si nje system dinamik, duhet pare ne teresine e faktoreve natyror, dhe te veprimt njerzor qe ushtrohen mbi te. ***Ato kane nje efekt te fuqishem mbi kushtet e jeteses se popullsise, dhe jane nje element baze per krijime te favorshme ekonomike.***

Vizioni i rrethit te Tiranes eshte rritja dhe zhvillimi i qendrueshem i ekonomise. Kjo kerkon qe konsideratat ekonomike, shoqerore e ekologjike te ekuilibrohen dhe qe cdo zhvillim te siguroje qe bazat e se ardhmes te kene te njetat alternative zhvillimi si bazat qe jetojne sot.

Kur parametrat mjedisore nuk jane konform ligjeve, normave dhe rregullave te mjedisit, rrjedhimisht kemi ndotje te tij, dhe prishje te ekuilibrave natyror.

Nxitja e zbatimit te ketyre normave kerkon nje perkujdesje nga ana ne organeve legjislative dhe vendimmarrese, ne menyre qe te rritet interesi si dhe detyrimi per ruajtjen e ekuilibrave natyror.

- Ne kete raport eshte trajtuar mjedisi i veprimtarise ne fushen e tregtim , lysterje te profileve te duraluminit dhe aksesoreve perkates te tyre.

Kjo eshte arritur duke:

- Dhene gjendjen reale nga pikpamja e ndikimit te ketij aktiviteti ne mjedisin human.
- Analizuar faktoret pozitiv dhe negative mjedisor
- Dhene rekomandimet per masat zbutese dhe minimizimin e ndikimeve negative ne mjedis.

Per kete eshte:

- Shfrytezuar informacioni baze i zones.
- Shfrytezuar dokumentacioni juridik dhe teknik i kompanise
- Marre takim me komunitetin e zones
- Marre takim specialist dhe drejtuesit e biznesit te shoqerise “ALUMIL-ALBANIA”sh.p.k.

2. Kuadri Ligjor

Relacioni u përgatit në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
 - *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
 - *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
 - *Urdhri e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
 - *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
 - *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
 - *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
 - *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
 - *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
 - *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
 - *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
 - *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
 - *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
 - *Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*
-

3. Pershkrimi i aktivitetit

Shoqeria "ALUMIL-ALBANIA" sh.p.k. ka per qellim te realizoje aktivitetin :

'Shkrirje e aluminit, trajtimi i profileve te aluminit, ngjyrosja e tyre si dhe instalimi i paneleve fotovoltaike per nevoja te vet proceseve teknologjike'

Shoqeria do te importoje nga jashte vendit, kryesisht vendet Ballkanike dhe Italia, lende te para, lingotat e aluminit, si dhe bojrat e perdorura ne procesin teknologjik. Produktet e ngjyrimet, bojrat jane m e cilesi te larte dhe brenda Normave te Komunitetit Europian (Crom free). Shoqeria "ALUMIL-ALBANIA" sh.p.k. do te zhvilloje aktivitetin e saj ne kete zone pasi vendi i zgjedhur ka keto perparsi :

- Pronesi mbi truallin dhe objektin (privat) e blere nga shoqeria
- Ndodhet jashte zones se banuar dhe vijave te verdha
- Nuk ka probleme sociale dhe mjedisore
- Ka infrastruktur te gatshme te favorshme
- Ka rezerva ujore te mjaftueshme
- Ndodhet fare prane rruges nacionale, Tirane-Durres

4. Vendodhja

Kapanoni industrial "Prodhim, tregtim, lyerje te profileve te duraluminit" ndodhet ne zonen e miratuar per aktivitet industrial.

Ajo shtrihet ne nje zone fushore dhe kufizohet:

- Veri Kufizohet me pasurine Nr. 148/36/41
- Lindje Kufizohet me pasurine Nr. 148/37
- Jug Rruga dytesore Tirane - Durres km7
- Perendim Kufizohet me pasurine 148/55/39

5. Pershkrimi i aktivitetit

Shoqeria "ALUMIL-ALBANIA" sh.p.k. ushtron aktivitetin e saj ne fushen "Prodhim, tregtim, lyerje te profileve te aluminit".

Kjo shoqeri e ka filluar aktivitetin e saj ne vitin 2004. Per zbatimin e procesit teknologjik jane instaluar paisje bashkekohore dhe moderne.

Lenda e pare sigurohet kryesisht nga firma greke dhe italiane.

Produkti i gatshem eshte i destinuar per nevojat e tregut te vendit, si dhe per eksport.

Shoqeria ka siguruar nje klientele te rregullt, cka vjen nga cilesia e mire e prodhimit.

Shoqeria "ALUMIL-ALBANIA" sh.p.k. ndodhet, ne Komunen Kashar. Kjo zone eshte e miratuar per zhvillimin e aktiviteve ekonomike dhe industriale.

Uji i nevojshem per procesin teknologjik dhe personelin sigurohet nga nje pus qe eshte hapur brenda terroorit i cili ploteson nevojat e furnizimit me uje teknologjik

Ne funksion te linjes teknologjike jane projektuar dhe kanalizimet dhe sistemi i shkarkimeve industrial.

Instalimet elektrike dhe ndricimi jane realizuar sipas standarteve bashkekohore duke lejuar nje dhe furrat e pjekjes jane teknologji me paisje bashkekohore si per kryerjen e procesit teknologjik ashtu edhe per treguesit e mbrojtjes se mjedisit sipas standarteve te Komunitetit

European .Funksionimi i tyre jepet ne menyre te detajuar ne pershkrimin e procesit teknologjik.

Vendodhja e objektit favorizohet nga nje infrastruktur e gatshme dhe lidhet me rrugen automobilistike, si per transportimin e lendeve te para ashtu dhe per shperndarjen e produktit te gatshem.

Gjithe njesia prodhim-magazinin eshte e vendosur ne nje hapesire te mjaftueshme per nje process optimal. Vendosja e gjithe paisjeve te nevojshme eshte zgjidhur ne menyre racionale, funksionale dhe shume praktike, si per realizimin e prodhimit ashtu dhe per personelin punonjes.

6. Procesi Teknologjik

Shoqeria “ALUMIL-ALBANIA” sh.p.k. do te ushtroje aktivitetin e saj ne fushen “Shkrirje e aluminit ,trajtimi i profileve te aluminit dhe ngjyrosja e tyre si dhe instalimi i paneleve fotovoltaike per nevoja te procesit teknologjik”.

Reparti i prodhimit (presat) : Makinerite qe disponon ky repart jane: Prese hidraulike Alumini 1800 ton e cila lingoten e zbutur ne varesi te kallepeve (matrica) te vendosura ne te e kthen ne profile me gjatesi rreth 24 m. Me pas profilet kalojne ne procesin e sharrimit ku priten ne gjatesi standarte prej 6 m. Kapaciteti prodhues afersisht per nje muaji i preses eshte 62.4 ton. Keto makineri punojne me energji elektrike dhe gas.

Reparti i matricave (kallephania): Makinerite qe disponon ky repart jane: Furre ngrohje formash , furre ngrohje teneferi, makineri bombardimi me rere si dhe aparati i matjes se fortesise, torno cnc skt 21, torno cnc skt lms, trapano kollon, trapano bango, prese ekcentrike e vogel. Keto makineri punojne me energji elektrike.

Reparti termik (paketimi): Makinerit qe disponon ky repart jane: Furre termike 6 ton, ventilator, vinç ure 3.2 ton , dhe nje impjant ftohes ajri. Kapaciteti 40 Ton. Kohezgjatja e procesit te temperimit eshte 2 ore dhe me pas profilet ftohen me ventilatoret e instaluar ne dalje.Keto makineri punojne me energji elektrike dhe gas.

Linja e ngjyrimit

Linja e ngjyrimit te profileve te aluminit eshte ndertuar dhe po menaxhohet nga nje staf me pervojete disa vjecare ne kete sektor te industries duke zbatuar nje teknologji bashkekohore si per cilesine e prodhimit ashtu dhe per treguesit e ndotjes se mjedisit.

Instalimi i paneleve fotovoltaike per nevoja te procesit teknologjik te kompanise.

Panelet fotovoltaike do të instalohen me qellim prodhimin e energjise per nevoja te proceseve teknologjike te vet kompanise.



Te dhenat Teknike per lendet qe perdoren. Masat e Sigurimit Teknik gjate operimit

Firma "ALUMIL-ALBANIA" sh.p.k. ka vlersuar maksimalisht ndikimin negative qe kane keto element ne mjedis dhe ka marre masa tekniko-administrative per instruktimin e detyrat e punonjesve qe punojne ne kontakt me keto element, si dhe paisjen me mjetet e nevojshme qe duhen per tu mbrojtur kunder tyre.

Ne paragrafet e Procesit Teknologjik jepet informacioni me i plot per perhapjen, efektet, dhe masat qe duhen marre.

Bojrat e mesiperme qe perdor procesi teknologjik te ardhura ne firma Euro Polverie srl. nuk paraqiten te rrezikshme per ambientin mbasi jane bojra ekologjike.

Furrat e polimerizimit nuk nxjerrin avuj te produkteve te rrezikshme sekondare te bojës.

Praktikisht procesi i pjekjes behet ne temperature te ulta (jo me shume se 200 grade Celcius) dhe polimeret e reshires poliester, perberese e bojës, nuk kane kushte per t'u zberthyer ne elemente te tjera te ndryshme, disa prej te cilave mund te paraqisnin dhe probleme mjedisore, te rrezikshme per shendetin e personelit operator dhe mjedisit.

Aktualisht avujt qe krijohen ne furre.

Normat e prodhimeve te produkteve te importuara (bojrat)dhe, qe aktualisht perdoren ne procesin teknologjik, i referohen normave te Komunitetit Europian. Bojrat jane te tilla qe nuk kane nevojë per solvent e produkte toksike gjate perdorimit (sic jane perdorur tradicionalisht ne teknologjite e meparshme te ngjyrimet) *dhe njihen si te pa rrezikshme per mjedisin.* Kjo reflektohet dhe ne certifikata e prodhimit.

Perdorime te rekomanduara.

Pudrat shume te pershtatshme per veshjen e artikujve qe perdoren ne ambientet e jashtme, ne te cilet perdoruesit mund te observojë vetite e rezistences ne thermim dhe stabilitet te ngjyres.

Aplikimi

Pudrat poliester jane te pershtatshme per perdorim me pajisje qe sprucojne pudren elektrostatike, e polarizuar nga nje gjenerator me tension te drejtuar midis 40- 90 kv. Ne cdo rast, per shkak te konduktivitetit te shkelqyer te ketyre pudrave, eshte e mundur te punohet me nje tension rreth 70 kv. Keshillohet te mos perdoret "overspray" (mbisprucim)

Hija e ngjyres dhe efekti metalit mund te ndryshojë mjaft duke pasur varacione te lehta te parendesishme te trashesise. (Shtrese se bojës)

Paketimi

Keto pudra mbahen ne thase special policeline te studiuar qe te shmangin kondesim brenda tyre. Keto thase jane te futur ne kuti qe vecantarisht te absorbojne dhe lageshtine minimale. Gjithe kutite permbajne 25 kg neto. Pervec disa produkteve te vecanta pasha e te cilave eshte 20 kg per secilen.

Sigurimi

Per rregullat e sigurise shoqeria ju eshte referuar fleteve te shenimeve per Sigurine Europiane (sds dir 93/112/eee) ne Procesin Teknologjik.

Ne kompleksin e shoqeris "ALUMIL-ALBANIA" sh.p.k, behen perpjekje te vazhdueshme per trajnimin e punonjesve, zbatohen rregulla e sigurimit ne pune, cikli 8-oresh dhe me nje ndrese sipas pozicionit, pushimet dhe ditet e festive ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi.

7. Pershkrimi gjeografik i zones

Tirana ndodhet 110 [metra](#) mbi nivelin e detit. Lartësia mesatare e fushës së Tiranës është 521 m, kurse dy malet më të larta rrez të cilëve shtrihet janë [Mali i Dajtit](#) me 1612 m dhe [Mali me Gropa](#) me 1828 m. Qyteti gjendet rreth 34 kilometra larg [detit Adriatik](#) në perëndim. Nga jugu dhe perëndimi rrethohet nga kodra relativisht të ulta, kurse nga ana veriperëndimore Tirana shtrihet mbi një zonë të rrafshët. Në periferinë veriore kalon [lumi i Tiranës](#). Disa kilometra më tutje nga ana jugore rrjedh [lumi i Erzenit](#). Sipërfaqja e qytetit të Tiranës është rreth 31 km², ndërsa sipërfaqja e gjithë rrethit është 1288 km² dhe përfshin katër qendra: Tiranën, [Vorën](#), [Krrabën](#) dhe [Kamzën](#) si dhe 150 fshatra. Qendrën e Tiranës e përshkon [përroi i Lanës](#) i cili në grykëderdhje bashkohet me [lumin Ishëm](#).

Kushtet klimatike

Ajri është me lageshti mesatare 60-80%. Përsa i përket cilesise se ajrit ai konsiderohet jo shumë i ndotur pasi zona nuk është zone industriale që të prodhojë gaze ndotëse për ajrin. Ndotja e ajrit vjen vetëm nga pluhurat që krijohen nga levizja e automjeteve apo dhe aktivitete të tjera njerëzore. Temperatura mesatare vjetore është 16°C. Sasia mesatare e reshjeve është 1297mm. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit 57m.

Tirana ka 331 ditë me diell në vit dhe këto kushtëzohen nga pozicioni gjeografik, vranësitat dhe pozicioni i vendit të matjes. Intensiteti i rrezatimit të drejtpërdrejtë i diellit është më i lartë në muajin Maj, ndërsa më i ulët në Dhjetor. Kurse vlera më e lartë në mesditë është gjatë muajit Korrik. Reshjet në Tirane kryesisht përfaqësohen nga rëniet e shiut, që kapin shifrën 128 –139 ditë reshje në vit. Lageshtia mesatare ditore e ajrit është rreth 72%. Tirana ka një thatësi të zgjatur që varion nga 9 deri 11 javë në vite.

Tirana - Temperatura dhe reshjet mesatare mujore

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Ø
Temp. Maks. (°C)	12	12	15	18	23	28	31	31	27	23	17	14	Ø 20,9
Temp. Mini. (°C)	-8	-8	-4	-1	3	6	11	10	5	1	-3	-7	Ø 0,4

Reshje (mm)	135	152	128	117	122	86	32	32	60	105	211	173	Σ	1.353
----------------	-----	-----	-----	-----	-----	----	----	----	----	-----	-----	-----	---	-------

Era

Eshte një element shumë i ndryshueshem nga një zonë në një tjetër për shkak të ndikimit të madh që relievi ka mbi të. Megjithatë, duke marrë parasysh kushtet gjeografike të zonës dhe relievit përreth, erërat nuk karakterizohen nga një shpejtesi e madhe . Erërat mbizotëruese janë kryesisht lindore dhe juglindore dhe ndonjëherë ka erëra te nxehta .

Lagështia

Zona ne fjale eshte e karakterizuar nga një nivel relativisht i lartë i lagështisë, me një vlerë vjetore mesatare prej 73%. Vlera më e ulët është vërejtur në korrik me 67% dhe më të lartë në dhjetor me 76%.

Toka/Flora/Fauna

Tokat ne kete zone jane ngjyre hiri, kafe qe shtrihen ne formen e brezave vertikale deri ne lartesite me te medha te zones. Ky ekosistem perfaqesohet nga tokat e mbjella me kultura te ndryshme bujqesore dhe nga druret frutore qe jane mjaft te perhapur ne kete rajon. Toka e zones nuk eshte e kultivueshme dhe nuk perfaqeson sipërfaqe te shfrytezueshme si kullote.

Vleresime te Ndikimeve ne Mjedis

Çdo aktivitet i çfardo natyre qofte karakterizohet nga efekte mjedisore negative apo pozitive te cilat sipas natyres mund te jene afatshkurter dhe/ose afatgjate, te minimizueshme ose te eliminueshme. **Evidentimi i tyre dhe marja ne konsiderarte gjate aktivitetit te ndikimit ne mjedis eshte parakusht per nje partneritet ne mbrojtje te mjedisit.**

Ndikime te Mundshme Negative

Do te trajtohen ndikimet e mundshme negative qe mendohet se do te gjenerohen nga zhvillimi dhe vazhdimesia e aktivitetit. Ato shfaqen gjate procesit te trajtimit te profileve dhe lyerjes se tyre. Manaxhimi korrket dhe monitorimi i vazhdueshem i tyre zvogelon keto efekte deri ne minimum duke mos sjelle deme per mjedisin dhe shendetin e punonjeseve dhe komunitetit ne afersi.

Ndikime te mundshme negative ne toke.

Duke ndjekur linjen qe po shqyrtojme hallkat qe mund te jene potencialisht burime shqetesimesh dhe burim ndotje ne personelin punonjes dhe mjedisin rrotull.

Relievi i zones ku eshte ndertuar kapanoni industrial eshte heterogjen. Tokat jane vende-vende te kafenjta te mbuluara me gjelberim, me livadhe, zone me bimesi te zones, tokat qe pjeserisht shfrytezohen nga komuniteti per kultivimin e produkteve bujqesore.

Tokat ne te cilen eshte ngitur kapanoni industrial i eshte nenshtuar tjetersimit. Aktiviteti nuk ndikon ne strukturen gjeologjike dhe topografike te tokes.

Ndikimet ne ajer

Nje nder elementet e rendesishme qe duhen marre ne konsiderate jane çlirimet ne ajer te cilat ne mungese te kontrollit mund te sjellin rrezik per ambientin.

Furrat e ngrohjes se lingotave punojne me lende te djegshme te gazta shkarkimi i te cilave eshte brenda normave te lejuara. Gjate ketij procesi kemi shkarkime te CO₂ dhe avujve te ujit.

Gjithashtu mundesi per shkarkime ne ajer jene dhe avujt qe dalin nga procesi i lyerjes. Ky proces eshte mjaft komod per operatorin dhe sistemin i aspirimit te dhomes se lyerjes mbasi fusha elktrostaikë e krijuar brenda kesaj dhome nuk lejon largimin e aerosoleve, terhequr grimcat e bojes drejt profilit qe lyhet.

Avujt dhe ererat qe clirohen nga pjekja e elementeve thithen nga aspiratori dhe pasi gurgullojne ne nje ene me uje, çlirohen ne atmosfere.

Ndikimi ne rregjimin e ujrave

Rregjimi i ujrave

Shkarkimet kane te bejne kryesisht me ujrat e vaskave te paratrajtimimit te elementeve.

Ujrat e vaskave nr.2-vaska e trajtimit acid e vaskes nr.4-vaska e trajtimit kromik dhe e vaskes nr.5-e shplarjes kromike.

Ne menyre periodike ne funksion te lendes se perpunuar behet pastrimi i vaskave nga mbetjet e dekantuara dhe mbeturinat mbasi kalojne ne nje process trajtimi neutralizimi, hidhen ne vend te caktuara nga Komuna.

Ujrat e vaskave 3,5 qe jane ujrat e shplarjes, jane objekti primar i impiantit te trajtimit te shkarkimeve. Ujrat shkarkohen periodikisht ne varesi te ngarkeses se punes. Keto ujra duhet te mos kaloje 0.5 mg/l te kromit total, ne varesi te ngarkeses se permbajtjes se tyre ne perputhje me **Vendimin Nr.177 dt.31.0.2005 per Normat e Lejuara te Shkarkimeve te Lengta dhe Kriteret e Zonimit te Mjedisese Ujore Prites**. Per kete keto arsye keto ujra trajtohen ne vaskat e trajtimit te shkarkimeve me substanca nutralizuese per te arritur ne vlerat 5,5-8,5 pH si dhe ujrat kromike sipas menyres se pershkruar ne paragrafet e mesiperme (Rregullimi i pH, Dobesimi, Kthjellimi)

Me tej mbas trajtimit kimik ne mjediset ujore prites, ujrat do te jene minimalisht te kontaminuar, brenda treguesve dhe normave te shkarkimeve industriale.

Ambjentet e linjes jane te hidroizoluara,shtruara dhe te paisura me se miri me sistemin e rrjetit te furnizimit me uje,si dhe paisjes se dysHEMEVE me kanalizimie.

Ndikimi ne regjimin e zhurmave ne mjedisin rrotull.

Zhurmat qe krijohen gjate procesit te punes japin nje impakt te paperfillshem te pranueshem jo vetem per zonat industrial por edhe per zonat urbane.

Ndikimi ne flore dhe faune.

Meqenese aktualisht do te kemi ndryshime te vogla sasiore te territorit te kapanonit industrial eshte vetem 1250 m² nuk pritet ndonje ndikim negative kumulativ ne flore.

Reagimi i faunes perfaqsohet nga llojet natyrore dhe te kultivuar. Llojet natyrore jane te pakta per nje siperfaqe qe ze ky aktivitet, dhe eshte e veshtire qe zhvillimi i tij te prishe nje habitat mjedisor. E vetmja rastesi mund te jete prishja e folenizimit nga zhurmat jo te medha specifike te aktivitetit (zhurmat e makinave te transportit dhe makinerive te linjes)

Ndikimi ne transport

Ndikimet negative nga rritja e intensitetit te transportit ne segmentin rruga kombetare Tirane-Durres do te ishin relativisht jo shume te konsiderueshme, por kumulative.

Sidoqofte do te veçoheshin:

- Ndotja e ajrit nga çlirimi i gazeve.
- Zhurmat.
- Risku i aksidenteve dhe bariera artificial (transport i shpesht i mjeteve ne rruge).

Plani i Monitorimit Mjedisor

Per tipin e aktivitetit qe kerkon te ndermarre shoqeria "ALUMIL-ALBANIA"sh.p.k. eshte e nevojshme qe te kryhet **vetmonitorimi** si me poshte:

- Te kryhet monitorimi permanent i te gjitha shkarkimeve te likuideve duke kryer neutralizimet ne rastet e nevojshme per te matur sasine e kriprave te Cr, Al, prezencen e F dhe ph e tyre.
- Te mirmbahet gropa dekantuese ku do te behet neutralizimi dhe dekantimi i lendeve te ngurta qe mund te dalin nga procesi.
- Mbetjet dekantuese qe dalin nga procesi teknologjik depozitohen perkohesisht ne vende te posaçme ne depozita dekantimi metalike te cilat nuk lejojne rrjedhje dhe krijojne mundesine per tu administruar dhe evaduar ne vendin e percaktuar nga organet shteterore.
- Te behet monitorimi periodik i emetimit te zhurmave ne mjedis.
- Te behet monitorimi periodik komponenteve te ajrit per te pare pranine e komponenteve te gazte si H₂S, CO, CO₂, CH₄ si dhe % e O₂
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik, si dhe me efektet gazrave, zhurmave etj në jetën e tyre të përditëshme si dhe të merren masat e duhura për monitorimin në vazhdimësi të tyre aparaturat dhe istrumentet e nevojshme.
- Në se do të punohet në orët e vona ose natën duhet të mbyllen dyert (qepenat) e magazinave për të bërë të mundur eliminimin në maksimum të zhurmave.
- Te pastrohen dhe mirembahen kanalet e shkarkimit dhe kullimit te ujrave te bardha.
- Te kontrollohet kompletimi me mjete mbrojtese nga zjarri, plan - sistemi i emergjencave i hartuar nga shoqeria dhe zbatimi i rregullave.

Konkluzione.

- Gjatë zhvillimeve të proceseve te punes te duraluminit te shoqerise "ALUMIL-ALBANIA" sh.p.k nuk ka shkarkime direkte ne mjedis te substancave të lëngeta të rrezikshme.
 - Zbatimi i projektit nuk do te kete ndonje pasoje negative te mundshme ne mjedisin e zones. Shkarkimet ne toke, uje dhe ajer do jene te kontrolluara dhe ne perputhje me normat e shkarkimeve ne fuqi. Aktiviteti nuk do te zhvillohet ne zone te mbrojtur ose zone turistike. Aktiviteti nuk shkakton zhurma, radiacione apo vibrime. Aktiviteti eshte larg zonave urbane.
 - Vendi eshte i pershtatshem, i aprovuar dhe nga pushteti vendor i Komunes Kashar.
-

- Niveli i zhurmave në repartet e prodhimit të produkteve të gatshme do jete në parametra normal dhe në nivele të prapueshme që nuk i kalojnë 75 dB. Të gjitha makineritë të cilat kanë emtime të mëdha zhurmash si për shembull sharrat prerese do jene të mbuluara me kapake izolimi akustik sipas standartit ISO 9001- 2008.
- Në çdo repart do të vendosen kuti të ndihmes së shpejte dhe çdo muaj do instruktohen punetoret për masat e sigurimit teknik. Në këto sektore gjithashtu do të funksionojnë dhomat e ndërrimit dhe dushet.
- Për një siguri maksimale në objekt do të zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes kundër zjarrit duke kryer instruktimin e punetoreve në mënyrë periodike.
- Vlerësohet projekti i paraqitur nga drejtuesit e shoqërisë "ALUMIL-ALBANIA" sh.p.k ka parashikuar të gjitha masat që duhet të merren në drejtim të disiplinimit të veprimeve, në mbajtjen e vlerave të intervenimit të agjentëve kimik, fizik e biologjik në mjediset e punës dhe në impaktin në mjedis të këtyre elementëve, duke përdorur teknologji moderne dhe automatike të cilat bëjnë të mundur një punë me efikasë dhe një impakt minimal në ambient.

Rekomandime.

- Të kryhet monitorimi permanent i të gjitha shkarkimeve të likuideve duke kryer neutralizimet në ratet e nevojshme për të matur sasinë e kriprave të Cr, Al, prezencën e F dhe pH të tyre.
 - Të ndërtohet një gropë dekantuese ku të bëhet neutralizimi dhe dekantimi i lendeve të ngurta që mund të dalin nga procesi.
 - Mbetjet dekantuese që dalin nga procesi teknologjik depozitohen përkoheishtë në vende të posaçme në depozita dekantimi metalike të cilat nuk lejojnë rrjedhje dhe krijojnë mundësi për tu administruar dhe evaduar në vendin e përcaktuar nga organet shtetërore.
 - Të bëhet monitorimi periodik i emetimit të zhurmave në mjedis.
 - Të bëhet monitorimi periodik i komponenteve të ajrit për të parë praninë e komponenteve të gazave si H₂S, CO, CO₂, CH₄ si dhe % e O₂.
 - Të njihen punonjësit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik, si dhe me efektet gazrave, zhurmave etj në punën e përditëshme si dhe të merren masat e duhura për monitorimin në vazhdimësi të tyre me aparaturat dhe instrumentet e nevojshme.
 - Nëse do të punohet në orët e vona ose natës duhet të mbyllën dyert (qepenat) e magazinave për të bërë të mundur eliminimin në maksimum të zhurmave.
 - Të pastrohen dhe mirembahen kanalet e kullimit të ujërave të bardha.
 - Të kontrollohet kompletimi me mjete mbrojtëse nga zjarri, plan - sistemi i emergjencave i hartuar nga shoqëria dhe zbatimi i rregullave.
-